Kronikë

Arrestohet Xhevdet Plaku dhe 6 të tjerë në Durrës, 'Akili' ishte arratisur nga burgu në Itali! U kapën në restorant të armatosur (VIDEO)

Shtatë persona të kërkuar nga drejtësia për vrasje dhe trafik droge, mes tyre Xhevdet Plaku, i arratisur nga burgu italian u kapën së bashku në Gjirin e Lalzit. Ata janë të akuzuar për ngjarje të ndryshme kriminale dhe nuk dihet se cfarë i bëri bashkë në "drekën e papërfunduar". Detajet e operacionit "Enigma" i bën të ditura drejtori i policisë së Durrësit.

- 'Policia barkas...'/ Të armatosur e duke ngrënë krudo, momenti kur efektivët 'mësyjnë' restorantin ku po drekonte Xhevdet Plaku në Gjirin e Lalzit
- Në drekën e 7 kriminelëve te Gjiri i Lalzit edhe kontakti i Çopjave, 5 mln € për 'kokën' e Alibejt! Në rrjetë edhe 'Akili' me 5 'jetë'
- Dy vëllezërit Voltan dhe Jugert Xhani dyshohen për organizim dhe sigurim kushtesh për vrasjen e Elis Roshkodolit në Shkodër
- Kush është Flobenc Meçia që u arrestua në Durrës! Franc Çobja i ofroi 5 mln euro për kokën e 'Krymit

Lajmi i fundit

Regjisori Mevlan Shanaj mesazh prekës: Ikja e Piro Milkanit është humbje kombëtare! Humba mikun e rinisë, baba i kinematografisë

24 Maj, 23:16

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
23 Maj, 09:55 | **Përditesimi: 24 Maj, 12:07**

Share

I arratisuri nga burgu italian, Xhevdet Plaku në shoqërinë e të shumëkërkuarit, Flobenc Meçja, vëllezërve në kërkim, Voltan dhe Jugert Xhani, u arrestuan duke drekuar në Gjirin e Lalzit. Bashkë me ta, në pranga ranë Alfred Hasanaj, Fatjon Qesja e Oltion Hasani, të akuzuar për moskallëzim krimi. Në pamjet e superoperacionit policor, dallohet që ata kapen me bukë në gojë, ndërsa pistoletat i mbanin në tavoline gati për qitje. Policia kishte një informacion në rrugë operative dhe ia behu në restorant, duke i zënë mat 7 personat e akuzuar per ngjarje te ndryshme kriminale, ndërsa po konsumonin një drekë luksoze me peshk e krudo.

> *"Operacion policor me rrezikshmëri të lartë, të koduar "Enigma, gjatë të cilit u kapën dhe u vunë në pranga 7 shtetas, ndërmjet tyre 3 shtetas me rrezikshmëri të lartë, të shpallur në kërkim më parë për vepra penale në fushën e krimeve kundër personit dhe në fushën e narkotikëve. Gjatë operacionit u sekuestruan 4 armë zjarri pistoleta të cilat këta shtetas i mbanin me vete, me fishekë në fole gati për qitje", tha Vilson Bala.*

Xhevdet Plaku që njihet me nofkën "Kiss" nga Durrësi ishte i shpallur në kërkim ndërkombëtar pasi është arratisur nga burgu i Ankonës në janar të këtij viti. 45-vjecari ishte dënuar në shtetin fqinj për trafik droge. Ndërsa Flobens Meçja, alias Gega alias Drini nga Shkodra ishte shpallur në kërkim nga SPAK-u prej një viti, si pjesë e dosjes "Plumbi i Artë". 43 -vjecari akuzohet për veprat penale "Organizata kriminale" dhe "Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve për të kryer vrasje". Gjatë kontrollit, iu gjetën dy dokumente identifikimi të falsifikuara dhe 1 armë zjarri pistoletë me fishek në fole gati për qitje.



LEXO EDHE:
Proda falënderon Policinë e Durrësit për operacionin e kapjes së Xhevdet Plakut: Rrit besimin te qytetarët, inkurajoj të vijojnë me të njëjtin përkushtim

Voltan Xhani është i dyshuari kryesor për organizimin e vrasjes së Elis Rroshkodolit në lagjen "Ahmet Haxhiu" në Shkodër mesditën e 30 gushtit 2024. Policia thotë se 39 vjecari, resident në Holandë, ka siguruar armët dhe makinat që u përdorën në vrasje, ndërsa i vëllai, Jugerti e ka përkrahur në krim. Dy vëllezerit, sipas të dhënave në QKR, janë pronarë të disa bizneseve.

Dyshohet se motivi i vrasjes së Rroshkodolit është përplasja për trafikun e drogës në Holande dhe Belgjikë. Më herët për këtë ngjarje është arrestuar nga policia e Shkodrës dhe Xhulio Malo, 26 vjeç. Ndërsa makina e përdorur në krim është gjetur asokohe e çmontuar në një servis në Mullet.

7 TË ARRESTUARIT NË GJIRIN E LALZIT
Xhevdet Plaku
Flobenc Meçja
Voltan Xhani
Jugert Xhani
Fatjon Qesja
Oltion Hasani
Alfred Hasanaj

KONTRATE SHITJE KUOTASH

Ne Tirane, sot me date 20/02/2020, nenshkruhet kjo kontrate mes paleve:
Z. Voltan Xhani , shtetas shqiptar, i biri i Petrit , lindur me 11.08.1986 , ne Permet dhe banues ne Tirane, mbajtes i ID nr.I60811065O, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar.
(Qe me poshte do te quhet **" SHITESI ")**

Z. Jugert Xhani , shtetas shqiptar, i biri i Petrit , lindur me 16.12.1990 , ne Permet , dhe banues ne Tirane, mbajtes i ID nr. J01216039G, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar.
(Qe me poshte do te quhet **" BLERESI"**)

Te përgjithshme

A. Shoqeria tregtare **"SANDRI 1980" sh.p.k** eshte rregjistruar si person fizik prane QKR Tirane , 04/09/2018, me NIPT L82104034H.
B. Kapitali i Shoqerise eshte 100.000 Lek, i ndare ne 100 pjese me vlere nominale 100 Lek secila.
C. Paraprakisht, ortaku i shoqerise **"SANDRI" sh.p.k** Z. Voltan Xhani, ka miratuar transferimin e kuotave te shoqerise ne masen 50% nepermjet shitjes se tyre Z. Jugert Xhani.
D. Shitesi, **Z.**Voltan XHani**,** eshte plotesisht dakord te shese me vullnetin e tij te lire dhe te plote 50 % te kuotave qe ai zoteron tek shoqeria **"Sandri 1980" sh.p.k** dhe bleresi Z. Jugert Xhani eshte plotesisht dakord te bleje nga Z. Voltan Xhani 50 % te kuotave te shoqerise **"Sandri 1980" sh.p.k**

Nisur nga sa me siper, Palët bien dakord si me poshte:

Neni 1
Objekti

1.1. Objekti i kësaj kontrate është shitja e kuotave te Shoqërisë **"Sandri 1980" sh.p.k** ne masen 50%, me një vlere nominale prej 100(njeqind) Lek secila. Këto pjese transferohen nga Shitësi Z. Voltan Xhani tek Blerësi Z. Jugert Xhani.

1.2. Blerësi pranon pronësinë mbi kuotat e Shoqërisë, me nje vlere nominale prej 100 (njeqind) Leke secila, te cilat perfaqesojne 50 % te Kapitalit te Shoqërisë dhe pranon te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga kjo pronësi.

Neni 2
Çmimi i Shitjes

2.1. Shitësi konfirmon qe është paguar plotësisht nga Blerësi, sipas çmimit te rene dakord midis tyre, vlera e kalimit te pronesise mbi kuotat e shoqerise **"Sandri 1980" sh.p.k** ne vlerën 50.000 lek dhe si rrjedhim ai transferon ne pronësi te Bleresit 50 % kapitalit te Shoqërisë.

Neni 3

SANDRI 1980 ALBANIA

Regjistrimi

3.1. Shitësi dhe Blerësi pranojne te zbatojnë e te japin, me kerkese te pales tjeter dhe/ose Shoqerise, te gjithe dokumentacionin e duhur ne pergjithesi, per te kryer çdo gje te nevojshme per transferimin e pjeseve te kapitalit, qe jane objekt i kesaj kontrate, dhe per te regjistruar kete transferim ne Regjistrin Tregtar prane QKR si edhe ne cdo organ tjeter shqiptar sipas ligjeve shqiptare.

Neni 4
Te ndryshme

4.1. Blerësi pranon dhe garanton shitësin se njeh te gjitha te drejta dhe detyrimet mbi kuotat qe bëhet pronare sipas gjendjes qe ndodhen ne momentin e realizimit te kësaj shitblerje.

4.2. Palet garantojne se ata e kane lexuar dhe kane kuptuar kete kontrate dhe nenet e saj.

4.3. Kjo kontrate , si dhe cdo marreveshje apo dokument tjeter qe ka lidhje me te, do te ekzekutohen dhe interpretohen sipas Ligjit Shqiptar. Juridiksioni kompetent eshte Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

Kontrata eshte bazuar ne Nenin 705 te Kodit Civil dhe Ligjin Nr. 9901 "Per tregtaret dhe shoqëritë tregtare" date 14.04.2008.

Kontrata u lexua para paleve, u gjend e rregullt, ne perputhje me vullnetin e tyre te lire dhe te plote, dhe u nenshkrua pa verejtje prej tyre.

PALET

SHITESI		**BLERESI**
Z.VOLTAN XHANI	SANDRI 1980 ALBANIA	**Z. JUGERT XHANI**

1

Në përditësim...

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 11:25

Kush është Flobenc Meçia që u arrestua në Durrës! Franc Çopja i ofroi 5 mln euro për kokën e 'Krymit', u 'tradhtua' nga bisedat në Sky Ecc



Flobens Meçja nga Shkodra, i njohur edhe me dy mbiemrat Gega dhe Drini, ishte shpallur në kërkim në kuadër të operacionit të koduar “Plumbi i artë”. 45-vjeçari nga Shkodra u arrestua në një operacion nga policia e Durrësit, teksa po drekonte me Xhevdet Plakun dhe pesë të tjerë në një restorant në Gjirin e Lalzit.

Mësohet se Meçjas i janë ofruar 5 milionë euro për vrasjen e Erion Alibejt, i njohur me nofkën Krymi. Emrin i tij del në disa biseda në SkyEcc me Franc Çopjan, i cili i ofron 5 milion euro për vrasjen e Erion Alibejt, i njohur me nofkën “Krymi”. Gjithashtu i ofron nga 1 milion euro për vrasjen e personave Arjan Spahiu, Aldo Baho dhe Ilir Lloshi, ku Flobenc Meçia është shprehur i gatshëm të kryejë vrasjet në fjalë.

Policia e Durrësit, në deklaratën për mediat sot, tha se ndaj 45-vjeçarit, GJKKO ka dhënë në muajin korrik 2024 masën e sigurisë “Arrest në burg”, për veprat penale “Organizata kriminale”, “Kryerja e veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal” dhe “Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve për të kryer vrasje”.

Gjatë kontrollit, këtij shtetasi iu gjetën dy dokumente identifikimi të falsifikuara dhe 1 armë zjarri pistoletë me fishek në fole gati për qitje.

Xh.D/Shqiptarja.com

Share

Ora 11:12

Operacioni në Durrës/ Mes të arrestuarve edhe Voltan dhe Jugert Xhani, dy vëllezërit dyshohen për organizim dhe sigurim kushtesh për vrasjen e Elis Roshkodolit në Shkodër

Dy nga të arrestuarit në Durrës, vëllezërit Voltan dhe Jugert Xhani, akuzohen se për sigurim kushtesh dhe përkrahje të autorit në lidhje me vrasjen e Elis Roshkodolit në Shkodër në gusht të vitit 2024

Policia tha se Voltan Xhani, 39-vjeç, ishte në kërkim pasi në shtator të vitit të kaluar, gjykata e Shkodrës kishte dhënë masën e sigurisë “arrest në burg” ndaj tij, për veprat penale “Trafikimi i mjeteve motorike” dhe “Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve për të kryer vrasje”, në funksion të hetimeve për zbardhjen dhe dokumentimin ligjor të vrasjes me armë zjarri të shtetasit Elis Rroshkodolit.

Ndërsa ndaj të vëllait Jugert Xhani, 35 vjeç, rëndojnë akuzat për veprat penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, “Moskallëzimi i krimit” dhe “Përkrahja e autorit të krimit”. Gjatë kontrollit iu gjetën 1 armë zjarri pistoletë dhe municion luftarak”.

Dy vëllezërve, gjatë momentit që u arrestuan teksa po drekonin në një restorant në Gjirin e Lalzit, iu gjetën edhe nga një armë zjarri pistoletë.

Xh.D/Shqiptarja.com

Share

Ora 11:02

‘Policia barkas...’/ Të armatosur e duke ngrënë krudo, momenti kur efektivët ‘mësyjnë’ restorantin ku po drekonte Xhevdet Plaku në Gjirin e Lalzit

Ky është momenti ky policia “mësyn” në restorantin në Gjirin e Lalzit, ku po drekonin shtatë personat që ranë në pranga në kuadër të operacionit të koduar “Enigma”, mes tyre edhe Xhevdet Plaku.

Në pamjet e superoperacionit policor, dallohet që ata kapen me bukë në gojë, ndërsa pistoletat i mbanin në tavoline gati për qitje. Në pamje dallohet edhe dreka luksoze me peshk e krudo.

Mes të arrestuarve është edhe Xhevdet Plaku, i njohur ndryshe edhe si Akili, me 25 identitete, ndaj të cilit ishte lëshuar një urdhër arrest nga autoritetet italiane pasi ishte arratisur nga burgu i Ankonës, ku po vuante dënimin për trafik lëndësh narkotike.

Të arrestuarit e tjerë janë Flobens Mecia alias Gega alias Drini, Voltan Xhani, Jugert Xhani, Oltion Hasani, Fatjon Qesja dhe Alfred Hasanaj. Disa prej tyre, në momentin e ndalimit, ishin edhe të armatosur.

Xh.D/Shqiptarja.com

Share

Ora 10:20

U arrestua në Durrës pas arratisjes nga burgu i Ankonës, kush është Xhevdet Plaku, i njohur si 'Akili'! Zbërthimi i Sky Ecc zbuloi planin për t'i bërë atentat në 2019 dhe kreu i një bande droge

Xhevdet Plaku, një person me rrezikshmëri të lartë është arrestuar në qytetin e Durrësit, pas arratisjes nga një burg në Ankona të Italisë ku vuante dënimin për trafik droge. I njohur i 'Akili', Gjykata e Breshias, Itali, ka lëshuar urdhër arresti ndaj tij për kryerjen e veprës penale "Trafikimi i narkotikëve". Ai është arratisur nga burgu i Ankonës, në muajin janar 2025 dhe për këtë arsye autoritetet gjyqësore italiane kanë lëshuar urdhër arresti për të.

Akili njihet edhe si kreu i një grupi të trafikut ndërkombëtar të drogës, të cilin e drejtonte nga Amsterdami dhe pakove iu vinte emra sipas cilësisë së mallit që kishte brenda. Zakonisht emra të markave të shtrenjtave të drogës duke nënkuptuar cilësinë e lartë të saj. "Hermes" ishte kokaina më e pastër e më pas vinin 'Lacoste', 'G4', 'Rolls Royce' e 'Playboy'. Emri i Xhevdet Plakut doli dhe në dosjen e SPAK për grupin e trafikut të drogës pjesë e së cilës ishte dhe ish-shef i krimeve të Komisariatit nr. 6 Dedan Gjoni dhe Erzen Breçani.

Zbardhja e përgjimeve të Sky ECC zbuluan se Akili, që përdorte 25 identitete, i akuzuar si kreu i një grupi të trafikut ndërkombëtar të drogës me qendër në Amsterdam u tentua të vritej nga i forti i Shijakut Rexhep Rapi më 17 shtator 2019. Përgjimet zbardhën bashkëpunimin e Rapit me Gjonin për të kryer vrasjen para komisariatit të Durrësit, si hakmarrje pasi e akuzonte për vrasjen e vëllait të tij Sali Rapi të ndodhur në 2014-ën në Itali.

Xhevdet Plaku nuk është një kriminel i zakonshëm. Ai ka një emër në botën e krimit. Ka dy vrasje pas tij. E para ka ndodhur në vitin 2000, kur vrau Sali Rapin, vëllain e Rexhep Rapit në Borghetto Santo Spirito, në provincën e Savonës. Një ekzekutim gjakftohtë me një plumb në kokë si pjesë e një grindjeje mes bandash, shkruan corriere.

Vrasja e dytë ka ndodhur tre vjet më vonë, në Durrës, ku ishte kthyer për të jetuar. Në vitin 2019, tentuan ta vrisnin ndoshta për të hakmarrë ndaj Rapit, por sulmi nuk u realizua kurrë.

Xh.D/Shqiptarja.com

Share

Ora 10:11

U kapën në një restorant, kush janë 7 të arrestuarit në Durrës, 3 me rrezikshmëri të lartë shoqërore! Mes tyre edhe Xhevdet Plaku

Drejtori i Policisë Vendore të Durrësit, Vilson Bala, në një konferencë për mediat, bëri me dije se 7 persona janë arrestuar në kuadër të operacionit të koduar "Enigma". Ndalimi i disa prej tyre u bë i mundur në një restorant në Gjirin e Lalzit. Mes të arrestuarve janë edhe Xhevdet Plaku, Flobens Mecia, Voltan Xhani, Jugert Xhani.

Xhevdet Plaku, i njohur edhe me nofkën "Akili", u arratis në janar të këtij viti në burgun e Ankokas në Itali, ku po vuante dënimin për trafik droge. Atij iu gjet një pistoletë me fishekë në fole gati për qitje. Në pranga ka rënë edhe Flobens Mecia alias Gega alias Drini, 43-vjeç, Voltan Xhani, 39-vjeç, dhe Jugert Xhani, 35-vjeç

> *"Xhevdet Plaku alias Kiss, 45 vjeç, banues në Durrës, i shpallur në kërkim ndërkombëtar nga ZQK Interpol Roma, pasi Gjykata e Breshias, Itali, ka lëshuar urdhër arresti për kryerjen e veprës penale "Trafikimi i narkotikëve". Ky shtetas është arratisur nga burgu i Ankonës, në muajin janar 2025 dhe për këtë arsye autoritetet gjyqësore italiane kanë lëshuar urdhër arresti për të. Gjatë kontrollit, këtij shtetasi iu gjet një armë zjarri pistoletë me fishek në fole gati për qitje;*
>
> *Flobens Mecia alias Gega alias Drini, 43 vjeç, banues në Shkodër, i shpallur në kërkim nga SPAK, pasi Gjykata e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në muajin korrik 2024, i ka caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg", për veprat penale "Organizata kriminale", "Kryerja e veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal" dhe "Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve për të kryer vrasje". Gjatë kontrollit, këtij shtetasi iu gjetën dy dokumente identifikimi të falsifikuara dhe 1 armë zjarri pistoletë me fishek në fole gati për qitje;*

Voltan Xhani, 39 vjeç, lindur në Përmet, rezident në Holandë, pasi në muajin shtator 2024, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër i ka caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg", për veprat penale "Trafikimi i mjeteve motorike" kryer në bashkëpunim dhe "Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve për të kryer vrasje", në funksion të hetimeve për zbardhjen dhe dokumentimin ligjor të vrasjes me armë zjarri të shtetasit E. Rr., ndodhur në Shkodër. Gjatë kontrollit fizik dhe në çantën e tij, Policia gjeti 1 armë zjarri pistoletë me fishkë në fole gati për qitje;

Jugert Xhani, 35 vjeç, lindur në Përmet, për veprat penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit", "Moskallëzimi i krimit" dhe "Përkrahja e autorit të krimit". Gjatë kontrollit iu gjetën 1 armë zjarri pistoletë dhe municion luftarak;

O. H., 38 vjeç, banues në Mamurras, i dyshuar për kryerjen e veprave penale "Moskallëzimi i krimit" dhe "Përkrahja e autorit të krimit";

F. Q., 36 vjeç, banues në Tiranë, për veprat penale "Moskallëzimi i krimit" dhe "Përkrahja e autorit të krimit";

A. H., 45 vjeç, banues në Mamurras, i dyshuar për veprat penale "Moskallëzimi i krimit" dhe "Përkrahja e autorit të krimit."

Po gjatë operacionit, janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale, shuma parash, euro dhe sende të tjera. ", njoftoi policia.

Xh.D/Shqiptarja.com

Share

Xh.D/SI.E./Shqiptarja.com

TAG: voltan xhani | Flobenc Mecja | Durres | xhevdet plaku

Komento

Komente

Iris: 24/05/2025 03:56

Ketij i them operacion i sukseshem-7 veta! Djemte e policise ishin me fat qe keta gango te armatosur nuk perdoren armet kunder tyre.Tani i takon drejtesise se re t'ua hedhe celsat ne det.

Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës:
Berisha kërkon anulim të zgjedhjeve, si ju duket?

24 Maj, 14:02

Alibi për humbjen | Kërkesë me bazë | I/e dyzuar

Lajme të tjera



Zgjedhjet/ KQZ certifikon rezultatet për 12 qarqet! PD konteston dhe ankimon Kukësin! Celibashi: DHL dorëzoi dokumentet për votat e Greqisë

24 Maj, 13:35

PAMJET/ Droni kap 'mat' kultivuesin e drogës në mes të serës me kanabis në Thumanë

24 Maj, 10:40



Në drekën e 7 kriminelëve te Gjiri i Lalzit edhe kontakti i Çopjave, 5 mln € për 'kokën' e Alibejt! Në rrjetë edhe 'Akili' me 5 'jetë'

Sokol Dema

23 Maj, 17:09



DOSJA/ 'Këtë javë e mbaruar', Deti garantoi kalimin e trafikantit në mënyrë të paligjshme drejt Italisë! Përgjimet e ryshfeti 3 mijë € policit

23 Maj, 15:50



Pacientja vdes pas operacionit për ngushtimin e stomakut në klinikën 'Villa Alba' në Durrës! Mjeku vihet nën hetim: Pësoi infarkt një ditë pas ndërhyrjes

22 Maj, 12:33

Ekzekutimi i anëtarit të grupit të Avdulajve në Durrës, dy në kërkim! Një maroken u solli mjetin autorëve një ditë para vrasjes më pas u larguan drejt Italisë

22 Maj, 10:17

Duka në 'Repolitix': PAA mori 20 mijë vota bio, pa ne PD më pak deputetë! Berisha gaboi me Kodin, zgjedhjet nuk ribëhen! S'besoja te rrotacioni, ja pse s'e urova Ramën

21 Maj, 23:02

Operacioni 'Ura'/ Beqiri në Report Tv: BKH po zbërthen SKY ECC! Softa: Droga blihej edhe me kripto! Topalli: Çoba drejtonte e rekrutonte! Basha: SPAK s'është më me 7 porta

21 Maj, 21:41

Akuzohet si drejtues i grupit kriminal në Durrës, kompania e Elvis Doçit mori leje nga KKT për ndërtimin e një hoteli në Durrës

21 Maj, 19:28

Debate në Këshillin Bashkiak Durrës/ Familje të përjashtuara nga rindërtimi, ata që kanë dy banesa ose ata që nuk janë banues në Durrës, s'janë përfitues

21 Maj, 16:58

Ekzekutimi i anëtarit të grupit të Avdulajve në Durrës, burime: Pista kryesore prishja e pazareve të drogës dhe hakmarrja! Vrasësi me pagesë për llogari të dikujt tjetër

21 Maj, 10:35

Durrës/ Gjendet tritol te 'Veliera' afër pallatit të Vangjush Dakos, ishte lidhur me një celular! Xhenierët bëjnë shpërthim të kontrolluar (VIDEO)

20 Maj, 22:52

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje